



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina-Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05Nr. 350/02-0108369/23 dt. 29.05.2023, të kërkuesve Albanë Kelmendi dhe Bujar Kelmendi nga Prishtina, me adresë Rr. Muharrem Fejza, obj. Hyjnesha D2/10-Mati 1, për ndërtimin e shtëpisë individuale, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “I-5-9”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e re- Zona Perëndimore” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 28.09.2023, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarëve Albanë Kelmendi dhe Bujar Kelmendi nga Prishtina, sipas kërkesës 05Nr. 350/02-108369/23 dt. 29.05.2023, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet P+1, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “I-5-9”, të Bllokut urban “I-5” të Tërësisë “I”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 391-13, ZK Çagllavicë.

II. Lokacioni i parcelës për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Parcelës ndërtimore: “I-5-9”, të Bllokut urban “I-5” të Tërësisë “I”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 Nr. 35-186850 dt.02.10.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë me destinim rezidencial për banim individual dhe miks. Pronari, me shkresën – Informim nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” me referencë 04 Nr. 350/01-103161/23 dt. 23.05.2023, lëshuar nga drejtoria e Planifikimit Strategjik të Komunës së Prishtinës, me datë 09.06.2023 përmes qendrës për shërbim me qytetarë, janë informuar për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit për atë zonë.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelës të lartcekur sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor është:

Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

- Nr. 391-13; S=867 m²; Albanë dhe Bujar Kelmendi; ”arë e klasës 4”.

- E drejta pronësore – juridike e parcelës është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.391-13 ZK. Çagllavicë, nuk ka ndërtesë të ndërtuar;
- Terreni ka pjerrtësi / disnivel nga drejtimi lindje – perëndim, me disnivel 1.0 m’;
- Qasja ekzistuese në parcelë kadastrale të lartshënuar, është nga rruga ekzistuese “Mehmet Isahi”;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m’ ka ndërtesa individuale të banimit/shtëpi;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Parcelës ndërtimore: “I-5-9”, të Bllokut urban “I-5” të Tërësisë “I”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urbane, kushtet për realizimin e ndërtimit, dhe janë:

- Organizimi me çasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimit, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distancë e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet

• Parcela kadastrale, me sipërfaqe të trajtuar në kuadër të parceles ndërtimore, të Bllokut urban "1-5", për realizimin e shtëpisë individuale P+1 që përfshihet në ndërtim – parcelë ndërtimore, konkretisht parcela kadastrale e trajtuar Brenda vijës rregulluese, është:

- Nr. 391-13.....S=827 m²;

• Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "1-5" të Tërësisë "1", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, planifikohet të ndërtohet shtëpi individuale me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

- Ndërtesa – Shtëpi individuale me S=441.40 m² / sipërfaqe mbi tokë është S=441.40m² dhe sipërfaqe nën tokë S=0.00m²,

- Etazhiteti P+1;

• Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore – brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e shtëpisë individuale, sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" është max. 40%,
 $S=827 m^2 \times 0.4 = 330.8 m^2$,

$S=202.5m^2$ -sipas projekt propozimit;

• Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHN), për bodrumin e shtëpisë ,sipas Planit është max.60%;

$S=827 m^2 \times 0.6 = 496.2 m^2$,

$S=0.00m^2$ - sipas projekt propozimit;

• Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, sipas pikës II të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.28.06.2023 dhe protokolluar me numrin 05 Nr. – 350/02-0108369/23, është 30%;

$S=827 m^2 \times 0.3 = 248.1 m^2$,

$S= 369.9 m^2$ - sipas projekt propozimit;

• Koeficienti i ndërtimit (ISPN) ,sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" është deri në 450 m²;

$S=441.4m^2$ sipas projekt propozimit;

• Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të komunës së Prishtinës dt.28.06.2023 dhe protokolluar me numrin 05 Nr. – 350/02-0108369/23, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;

• Ngrija e nivelit të përdhësës nga rruga / niveli I terrenit, të jetë 0.45 m’;

• Distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m’;

• Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj. nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0 m’ nga parcela fqinje;

• Rrethojat kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50 cm’, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përskaaj rrugës ka lartësi prej max.1.5 m’ ndërsa në kufi me parcelën fqinjë mund të jetë max 2.0 m’;

• Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vend parkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke respektuar kushtin prej 30% për gjelbërim;

• Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;

• Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe t’i përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;

• Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

• Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;

- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe çertifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrikë dhe ujë).

Kuqja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyqje nga "Termokos" – Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni Ndërtimor – projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale – perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore – meqenëse parcela kadastrale nr.391-13 ZK. Çagllavicë, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës – tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasës 4", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11,13 dhe 14 të ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8,9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do t'i ndërrohet destinimi, do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim – pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën para zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e Lejes Ndërtimore.

VIII. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas " Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01-0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

ndertimeve, me pagesen e takses se percaktuar ne pikën 5.9 te nenit 5 te rregullores se larte cekur une vendimit për lejimin e rrënimt.

IX. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimt për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronarët Albanë Kelmendi dhe Bujar Kelmendi banorë nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-0108369/23 dt. 29.05.2023, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet P+1, në kuadër të Parcelës ndërtimore: "I-5-9", të Bllokut urban "I-5" të Tërësisë "I", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale 391-13 ZK Çagllavicë, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- *Dëshmia mbi pronësinë, kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale të parcelave nr.391-13 ZK Çagllavicë lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Inçizimin gjeodezik, punuar nga gjeodeti i licencuar Hekuran H. Demiri, me numër licence 151;*
- *Informatën nga "Plani Rregullues Prishtina e Re-Zona Perëndim" me referencë 05 – 350/02 – 0108369/23 dt. 09.06.2023, lëshuar nga drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e letërnjoftimit të pronarve ;*
- *Vërtetimi mbi obliguesin tatimor të Albanë dhe Bujar Kelmendi, nr.10-430/03-0103386/23 dt.23.05.2023;*
- *Projektin ideor për ndërtesën-shtëpi individuale banimore, të hartuar nga "Archipoints Group " Sh.P.K., me numër unik identifikues 810007709, përfaqësues Ertan Sylejmani dhe Meriton Bajrami;*
- *Fotot e lokacionit*

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës për kushte të ndërtimit 05 Nr. 350/02-0108369/23 dt. 29.05.2023, trajtimit-shqyrtimit të saj, me dokumentacion të prezantuar me këtë dosje, konsultimit të lokacionit në fjalë, rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht verifikimit të gjendjes faktike në terren, në mënyrë kronologjike konstatoi zhvillimin e procedurave dhe faktet që kanë qar deri në vendosjen e çështjes administrative, si në vijim:

Aplikuesit, me kërkesën 05 Nr. 350/02-0108369/23 dt. 29.05.2023, kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet P+1, në kuadër të parcelës kadastrale 391-13 ZK Çagllavicë dhe në kuadër të Parcelës ndërtimore: "I-5-9", të Bllokut urban "I-5" të Tërësisë "I", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-ZONA Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është paraparë të jetë me destinim rezidencial për banim individual dhe mik.

Duke u bazuar në nenin 18 të ligjit Nr.04/L-110 për ndërtim, pikën 1,2 dhe 1.2.2 të nenit 1.3 të udhëzimit administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 18.07.2023 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m', për të njoftuar publikun me synimin e pronarit , për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhdat të qëndroj deri më datën 25.07.2023, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje / sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar , si ne vijim: "Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të

Albanë, Bujar Kelmendi, në Çagllavicë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-108369/23 dt.29.05.2023, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese "Mehmet Isahi", për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese ne raport me parcelën 391-13. Kyçja duhet të përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese, të aplikohet profilimi i rrugës sipas zgjidhjes urbane, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes. "

Bazuar në konstatimet e mësipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt.31.07.2013, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – "Zgjidhja Urbane", është në harmoni me destinimin dhe kriteret e tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i Situacionit – Zgjidhja urbane dhe "Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF01" të punuar nga kjo Drejtori.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-0108369/23 dt. 29.05.2023, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 0108369/23 DT.28.09.2023**

Zyrtare,
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit.
Nazife Krasniqi






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01





Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: _____

Legjenda:

- Riparcelimi sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale

Date	Description	Amount	Balance
1890			
Jan 1	Balance forward		
Jan 15	Received from A. B.		
Jan 20	Received from C. D.		
Jan 25	Received from E. F.		
Jan 30	Received from G. H.		
Feb 5	Received from I. J.		
Feb 10	Received from K. L.		
Feb 15	Received from M. N.		
Feb 20	Received from O. P.		
Feb 25	Received from Q. R.		
Feb 30	Received from S. T.		
Mar 5	Received from U. V.		
Mar 10	Received from W. X.		
Mar 15	Received from Y. Z.		
Mar 20	Received from A. B.		
Mar 25	Received from C. D.		
Mar 30	Received from E. F.		
Apr 5	Received from G. H.		
Apr 10	Received from I. J.		
Apr 15	Received from K. L.		
Apr 20	Received from M. N.		
Apr 25	Received from O. P.		
Apr 30	Received from Q. R.		
May 5	Received from S. T.		
May 10	Received from U. V.		
May 15	Received from W. X.		
May 20	Received from Y. Z.		
May 25	Received from A. B.		
May 30	Received from C. D.		
Jun 5	Received from E. F.		
Jun 10	Received from G. H.		
Jun 15	Received from I. J.		
Jun 20	Received from K. L.		
Jun 25	Received from M. N.		
Jun 30	Received from O. P.		
Jul 5	Received from Q. R.		
Jul 10	Received from S. T.		
Jul 15	Received from U. V.		
Jul 20	Received from W. X.		
Jul 25	Received from Y. Z.		
Jul 30	Received from A. B.		
Aug 5	Received from C. D.		
Aug 10	Received from E. F.		
Aug 15	Received from G. H.		
Aug 20	Received from I. J.		
Aug 25	Received from K. L.		
Aug 30	Received from M. N.		
Sep 5	Received from O. P.		
Sep 10	Received from Q. R.		
Sep 15	Received from S. T.		
Sep 20	Received from U. V.		
Sep 25	Received from W. X.		
Sep 30	Received from Y. Z.		
Oct 5	Received from A. B.		
Oct 10	Received from C. D.		
Oct 15	Received from E. F.		
Oct 20	Received from G. H.		
Oct 25	Received from I. J.		
Oct 30	Received from K. L.		
Nov 5	Received from M. N.		
Nov 10	Received from O. P.		
Nov 15	Received from Q. R.		
Nov 20	Received from S. T.		
Nov 25	Received from U. V.		
Nov 30	Received from W. X.		
Dec 5	Received from Y. Z.		
Dec 10	Received from A. B.		
Dec 15	Received from C. D.		
Dec 20	Received from E. F.		
Dec 25	Received from G. H.		
Dec 30	Received from I. J.		
Total			



• LLOGARITJET E SIPERFAQEVË TË NDËRTIMIT
 • NGASTRA 391-13
 SIPERFAQA E NGASTRËS
 $S = 867 \text{ m}^2$
 SIPERFAQA E PARCELES NDËRTIMORE
 $S = 827 \text{ m}^2$
 • INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË PARCELES:
 $ISHP = 0.4 (40\%)$
 • INDEKSI I SIP. PËRGJITHSHME NDËRTIMORE:
 $ISPNI = \text{MAX } 450 \text{ m}^2$
 • INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË NËNTOKES:
 $ISN = 0.6 (60\%)$
 • INDEKSI I SHFRYTËZIMIT TË GJELBERIMIT:
 $ISGJ = 0.25 (30\%)$
 • ETAZHJETI MAX P+2

• SIPERFAQA E LEJUAR PËR SHPUKË:
 $S = 827 \times 0.4 = 330.8 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA E LEJUAR PËR NDËRTIMI:
 $\text{MAX } 450 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA E LEJUAR PËR GJELBERIM:
 $S = 827 \times 0.25 = 206.75 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA E PËRDHESËS:
 $S = 202.5 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA E KATIT:
 $S = 238.9 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA TOTALE E OBJEKTIT:
 $S = 441.4 \text{ m}^2$
 • SIPERFAQA E GJELBERIMIT SIPAS PROJEKTTI:
 $S = 317.3 \text{ m}^2$